



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK DIVJAKË

Nr 8698/32 Prot.

Divjakë më 27/08 / 2025

RAPORT VENDIMMARRJE

I Komisionit të Arsimit të Këshillit Bashkiak Divjakë

Komisioni i Arsimit i Këshillit Bashkiak Divjakë, në mbledhjen e tij, shqyrtoi dhe analizoi Planin e Arsimit Parauniversitar të Bashkisë për periudhën afatmesme. Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe konsultimeve publike me institucionet arsimore, dhe palet e interes, komisioni thekson rëndësinë e këtij plani për zhvillimin e sistemit arsimor lokal dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit.

Baza Ligjore, Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 27.02.2019, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2019–2025”; Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për hartimin dhe zbatimin e planeve vendore; Strategjitë kombëtare për zhvillimin e arsimit dhe procesin e integritimit evropian.

Rëndësia e Planit, Plani i Arsimit Parauniversitar është një dokument strategjik që synon: Përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe kushteve të të nxënit; Rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përgatitjes së mësuesve; Sigurimin e aksesit të barabartë në arsim për të gjithë fëmijët; Mbështetjen e arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara; Zvogëlimin e braktisjes shkollore dhe rritjen e përfshirjes së komunitetit; Përmirësimin e partneriteteve ndërmjet shkollës, familjes dhe komunitetit.

Rekomandimi : Komisioni i Arsimit, pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe bazën ligjore, arrin në përfundimin se Plani i Arsimit Parauniversitar është një domosdoshmëri për zhvillimin afatgjatë të arsimit në Bashkinë Divjakë.

Ky plan siguron një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe përgatitjen e brezave të ardhshëm.

Në këtë kuadër, Komisioni i Arsimit i propozon Këshillit Bashkiak Divjakë miratimin në tërësi të Planit të Arsimit Parauniversitar.

KOMISIONI I ARSIMIT, RINISË, KULTURËS, SPORTEVE DHE TURIZMIT.

1. Elmerina Sina (kryetar)

2. Elizabeta Rredhi (zv.kryetar)

3. Indrit Zgjana (sekretar)

4. Juljan Vrapit (anëtar)

5. Sokol Kaloshi (anëtar)

